



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.17

27 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 066 datë 2.2.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”	1127
Ligj nr.10 068 datë 2.2.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	1128
Ligj nr.10 069 datë 5.2.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për bashkëpunimin për zhvillim”	1129
Ligj nr.10 070 datë 5.2.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ...	1137
Vendim i Kuvendit nr.237, datë 5.2.2009	Për emërimin e një anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)	1139
Vendim i Kuvendit nr.238, datë 5.2.2009	Për riemërimin e kryetarit të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)	1139
Dekret nr.6064 datë 19.2.2009	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	1140
Udhëzim i MF dhe MPPTT nr.10, datë 30.1.2009	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me pasaportë lundrimi	1141
Rregullore e MMPAU nr.6, datë 13.2. 2009	Për përcaktimin e mënyrës së regjistrimit të informacioneve të nevojshme në lidhje me zëniet e peshkut	1142
Udhëzim i KQZ nr.1, datë 20.2.2009	Për organizimin dhe funksionimin e zyrave rajonale zgjedhore	1154

Vendim i ERE nr.8, datë 4.2.2009	Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregimit të energjisë elektrike	1158
Vendim i KKRT nr.755, datë 30.1.2009	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV K8”	1159
Vendim i KKRT nr.756, datë 30.1.2009	Për moszgjerim zone licencimi për televizionin privat vendor “Tv Fokus”	1159
Vendim i KKRT nr.757, datë 30.1.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Kiss”	1160
Vendim i KKRT nr.758, datë 30.1.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Ora”	1160
Vendim i KKRT nr.759, datë 30.1.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Spartak Sm”	1161
Vendim i KKRT nr.760, datë 30.1.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Jehona”	1161
Vendim i KKRT nr.761, datë 30.1.2009	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio Take 5”	1162
Vendim i KKRT nr.762, datë 30.1.2009	Për mosdhënie licence për radion private vendore “RADIO G-KAM”	1162
Vendim i KKRT nr.763, datë 30.1.2009	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio Dajçi”	1163
Vendim i KKRT nr.768, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Rock”	1163
Vendim i KKRT nr.769, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv Kombi”	1164
Vendim i KKRT nr.770, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Kopluku”	1164
Vendim i KKRT nr.771, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Dj 96.1”	1165
Vendim i KKRT nr.772, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Tele 1”	1165
Vendim i KKRT nr.773, datë 30.1.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “2ATV”	1166
Kërkesë e MPPTT nr.246/2, datë 30.1.2009	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Rrëshen”	1166

LIGJ
Nr.10 066, datë 2.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8952, DATË 10.10.2002 “PËR DOKUMENTIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “dokument identiteti” zëvendësohen me fjalën “letërnjoftim”.

Neni 2

Në të gjitha aktet ligjore e nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji, fjalët “dokument identiteti” zëvendësohen me fjalën “letërnjoftim”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6065, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 068, datë 2.2.2009

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 19 “Furnizimet e përjashtuara”, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8 dhe 26.1 të këtij ligji.”.

Neni 2

Pas nenit 25.7 shtohet neni 25.8 me këtë përmbajtje:

“Neni 25.8

Furnizimi i kartave të identitetit është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 3

Neni 26/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26/1

Është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja:

a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat, brenda vendit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji;

b) importimi i mallrave të vendosura në regjimin e tranzitit;

c) importimi i mallrave të deklaruara për të qenë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv;

ç) importimi i mallrave dhe i shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

“Operacione hidrokarbure”, për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet”, të ndryshuar;

d) importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm;

dh) importimi i mallrave nga NATO-ja dhe organizmat e saj, në kuadër të operacioneve, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

e) importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet e Aleancës së NATO-s dhe ato partnere;

ë) importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

f) importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6067, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.10 069, datë 5.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për bashkëpunimin për zhvillim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6068, datë 29.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE KUADËR
MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Duke konsideruar që:

- të vetëdijshme për lidhjet ekzistuese të miqësisë, dy vendet kanë për qëllim të forcojnë këto marrëdhënie mbi bazën e barazisë dhe interesit reciprok, edhe nëpërmjet zgjerimit dhe intensifikimit të aktiviteteve të bashkëpunimit për zhvillim;

- të dyja qeveritë synojnë të realizojnë aktivitete bashkëpunimi sipas strategjive të zhvillimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe koherente me linjat e drejtimit dhe programin e Ministrinë e Punëve të Jashtme–Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillimit (në vijim Kooperacioni Italian),

duke konsideruar të gjitha këto, qeveritë bien dakord për sa vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe kuadri i aplikimit të Marrëveshjes

1. Marrëveshja kuadër e bashkëpunimit (në vijim marrëveshja) tregon afatet dhe kushtet përmes së cilave qeveria italiane, nëpërmjet Kooperacionit Italian dhe enteve zbatuese të iniciativave të financuara nga kjo zyrë, zotohet të ndihmojë qeverinë shqiptare.

2. Marrëveshja do të gjejë zbatim në të gjitha aktivitetet mbështetëse të ofruara nga Kooperacioni Italian, përfshirë këtu ato të rregulluara nga marrëveshjet e projekteve ose nga akte të tjera midis palëve, që kanë për qëllim të disiplinojnë projekte specifike, në tërësi ose pjesërisht.

Neni 2

Autoritetet kompetente

1. Me qëllim vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjeve specifike të projekteve, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti për Bashkërendimin e Strategjive dhe Koordinimin e Ndihmës së Huaj do të përfaqësojnë Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Punëve të Jashtme–Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (MPJ-DPBZH), edhe nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe/ose zyrës për të cilën do të flitet në nenin 7, do të përfaqësojë Qeverinë e Republikës Italiane. Në vazhdim subjektet e lartpërmendura do të quhen së bashku “palë” ose në mënyrë të veçantë “pala”.

Neni 3

Objektivat dhe parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Palët impenjohen të promovojnë, në kuadrin e legjislacioneve përkatëse të çdo vendi, programe dhe projekte të përbashkëta të bashkëpunimit për zhvillim.

2. Palët impenjohen të fokusojnë aktivitetin e bashkëpunimit për zhvillim në parimet e vendosura nga Deklarata e Parisit mbi efikasitetin e ndihmave dhe të ndërmarrin veprime mbi realizimin e parimeve të pronësisë, bashkërendimit, harmonizimit, administrimit të rezultateve dhe përgjegjësisë reciproke.

KREU II ZBATIMI I PROJEKTEVE

Neni 4

Mënyrat e identifikimit të programeve dhe projekteve

1. Iniciativat e Kooperacionit Italian nisin pas një kërkesë me shkrim të paraqitur nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë bazohet në propozimin e bërë më parë në Ministrinë e Financave nga Departamenti për Bashkërendimin e Strategjive dhe Koordinimin e Ndhmës së Huaj. Kooperacioni Italian vlerëson çdo iniciativë në bazë të procedurave të veta dhe duke vlerësuar burimet financiare të disponueshme.

2. Çdo iniciativë uniformohet me linjat orientuese të vendosura në programin e vendit dhe protokollin e bashkëpunimit të miratuar midis palëve (në vijim i referuar si “Protokolli i bashkëpunimit”). Përkufizimi i protokollit të bashkëpunimit përfaqëson pikën e referimit për të identifikuar, përgatitur dhe vlerësuar çdo projekt për zhvillim.

3. Çdo projekt rregullohet sipas një marrëveshjeje specifike të projektit dhe, nëse është e nevojshme, nga një marrëveshje financiare, të cilat tregojnë me detaje të drejtat dhe detyrimet specifike të çdonjërit prej subjekteve të përfshira në zbatimin e këtij projekti.

4. Mënyrat e përzgjedhjes së furnizuesve të të mirave, shërbimeve dhe punimeve përcaktohen nga normat mbi prokurimin, të parashikuara nga Komisioni Europian për ndihmat në vendet e treta, përveç rasteve kur marrëveshja e projektit i parashikon shprehimisht ndryshe. Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me projektin do të përcaktojnë shprehimisht ligjin e zbatueshëm.

Neni 5

Enti zbatues

1. Çdonjëra nga palët, në hapësirat respektive, mund të emërojë cilindo autoritet qeverisës ose cilëndo organizatë tjetër si enti zbatues përgjegjës për realizimin e iniciativave të bashkëpunimit, të përmendura në këtë Marrëveshje, sipas afateve dhe kushteve të vendosura mes vetë palëve.

2. Mund të marrë rolin e entit zbatues:

- a) një institucion apo një organizatë joqeveritare italiane;
- b) një institucion shqiptar;
- c) një organizatë ndërkombëtare.

3. Enti zbatues zbaton projektin ose pjesë të tij sipas modaliteteve dhe termave specifike që rregullohen në Marrëveshjen përkatëse të projektit, në kontrata, marrëveshje financiare ose në instrumente të tjera ekzekutive të besuara.

4. Nëse zbatimi i besohet direkt Kooperacionit Italian, referimet mbi entin zbatues që përfshihen në këtë Marrëveshje, duhet të nënkuptohen të referuara ndaj vetë Kooperacionit Italian, vetëm nëse nuk përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e projektit.

Neni 6

Format e bashkëpunimit

1. Kooperacioni italian mund të ofrojë bashkëpunim teknik, financiar, ndihmë humanitare ose ndihmë për emergjenca. Ndërhyrjet mund të jenë të kanalizuar në mënyrë dypalëshe ose në bashkëpunim me donatorë të tjerë apo organizata shumëpalëshe.

2. Instrumentet financiare të adaptuara nga Kooperacioni Italian për Zhvillim mund të jenë vijuese:

- a) dhurata;
- b) kredi ndihme;
- c) kredi të kushtëzuara, në rastin e formimit të *joint ventures*.

3. Llojet e kontributeve financiare që mund të akordohen jashtë kuadrit të protokollit të bashkëpunimit janë vijueset:

- a) ndihma emergjence;
- b) kontribute për projekte të nxitura nga OJQ italiane dhe autoritetet lokale;
- c) kontribute financiare për *joint-ventures*;
- d) konvertim i huasë;
- e) bursa studimi.

Neni 7

Bashkëpunimi i decentralizuar

1. Me bashkëpunim të decentralizuar do të kuptohet çdo lloj bashkëpunimi dhe veprimtarie ndërkombëtare e realizuar mes subjekteve territoriale italiane dhe shqiptare edhe me pjesëmarrjen e aktorëve përkatës të shoqërisë civile, duke pasur si objektiv fuqizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, sipas politikave të jashtme të të dyjave qeverive.

2. Palët zotohen të favorizojnë bashkëpunimin e decentralizuar ndërmjet autoriteteve vendore në forma të ndryshme sipas dispozitave kushtetuese dhe legjislative përkatëse.

3. Palët janë të ndërgjegjshme që kjo formë e re bashkëpunimi, e karakterizuar nga një pjesëmarrje e gjerë popullore dhe nga të mira reciproke ka specifikën dhe vlerën e vet, në sektorë, si për shembull, lufta kundër urisë dhe varfërisë, përfshirja sociale, promovimi i proceseve të demokracisë pjesëmarrëse dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik dhe territorial.

4. Palët njohin të drejtën që pushteti vendor të nënshkruajë marrëveshje me entet homologe për aktivitete bashkëpunimi. Këto marrëveshje duhet të përcaktojnë objektivat dhe sektorët e ndërhyrjes dhe mund të tregojnë parashikimet e impenjimeve financiare. Për të përfutur nga kjo Marrëveshje, aktet duhet t'u dërgohen për dijeni autoriteteve kombëtare kompetente sipas procedurave të parashikuara nga rregullat përkatëse të çdo vendi, dhe të bëjnë pjesë në programe dhe marrëveshje kuadër bashkëpunimi, për të cilat qeveritë përkatëse kanë rënë dakord.

5. Palët zotohen t'i orientojnë veprimtaritë e bashkëpunimit të decentralizuar, duke i futur ato në protokollin e bashkëpunimit ose në programe kuadër tripalëshe ose shumëpalëshe që parashikojnë linja dhe tregues të prioriteteve tematike dhe territoriale, si dhe mënyrat e përshtatshme të bashkëfinancimit.

6. Me përjashtim të disa parashikimeve për të cilat palët bien dakord rast për rasti, veprimtaritë e bashkëpunimit të decentralizuar mund të parashikojnë:

- a) dërgimin, nga ana e pushtetit vendor, të ekspertëve, konsulentëve dhe personelit teknik dhe/ose administrativ;
- b) rekrutimin në vend të ekspertëve, konsulentëve dhe personelit mbështetës;
- c) aktivitete të enteve publike ose private të bazuara në territor ose të lidhura me partnerë territorialë (universitete, dhoma tregtie, sindikata, institute, agjenci ndërmarrje, organizata joqeveritare);
- d) dërgimin e të mirave materiale dhe blerjen e shërbimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive për të cilat është rënë dakord;
- e) dhënien e bursave të studimit;

f) pjesëmarrje financiare në programe dhe projekte zhvillimi të organizmave ndërkombëtarë;

g) pjesëmarrje e pushtetit vendor, nëpërmjet teknikëve dhe funksionarëve të tyre, në misione të bashkëpunimit dypalësh ose tripalësh.

7. Për të verifikuar shkallën e aplikimit të këtij neni dhe për të gjetur instrumente të reja që mund të rrisin efikasitetin, vizibilitetin dhe impaktin e bashkëpunimit të decentralizuar, palët zotohen të krijojnë një komitetit të përbashkët të përbërë nga qeveritë kombëtare përkatëse dhe nga institucione vendore të të dy vendeve të interesuara për çështjen, i cili do të mbledhet çdo vit.

8. Palët zotohen të realizojnë në mënyrë periodike forume dhe takime direkte për formulimin e strategjive të përbashkëta dhe për të stimuluar krijimin e rrjeteve të enteve vendore.

9. Për iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar dhe për personelin që lidhet me to, aplikohen dispozitat për të cilat flitet në nenet 12 deri në 15 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Klauzola antikorrupsion

1. Palët kanë një interes të përbashkët në luftën kundër korrupsionit, që dëmton qeverisjen e mirë dhe përdorimin korrekt të burimeve të nevojshme për zhvillimin dhe që për më tepër dëmton konkurrencën e drejtë dhe të hapur, bazuar mbi cilësinë dhe çmimet. Deklarojnë pra qëllimin për të bashkuar përpjekjet e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe që, për pasojë, asnjë ofertë, dhuratë, pagesë apo përfitim o ndonjë lloji që do të përbënte një akt jo ligjor korrupsioni, nuk do të ndodhë apo kryhet si drejtpërdrejt, ashtu dhe jodrejtpërdrejt, me qëllim ekzekutimin, apo si shpërblim për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo akt apo fakt që të çon në këtë lloj veprimi, përbën një element të mjaftueshëm për t'u tërhequr nga Marrëveshja ose për të ndërmarrë çdo masë tjetër korrigjuese të parashikuar nga legjislacioni i palëve.

Neni 9

Verifikime administrative kontabël

1. Qeveria e Republikës Italiane mund të kryejë pranë enteve zbatuese të gjitha rishikimet e llogarive ose kontrollet administrative që i quan të nevojshme dhe që kanë të bëjnë me përdorimin e fondit italian në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Konsultimet

1. Për të vlerësuar iniciativat në zbatim dhe për të planifikuar ato të ardhshmet, palët konsultohen në mënyrë të vazhdueshme dhe shkëmbejnë gjithë informacionin e nevojshëm për arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët takohen të paktën një herë në vit dhe çdo rast tjetër që njëra prej tyre e quan të nevojshme, për të verifikuar gjendjen e zbatimit të programeve të parashikuara në protokollin e bashkëpunimit, për të rënë dakord mbi prioritetet e përbashkëta dhe mbi parimet e bashkëpunimit, për të gjetur orientimet e duhura për realizimin e programeve dhe projekteve të ardhshme të bashkëpunimit për zhvillim. Në përfundim të çdo takimi përpilohet një procesverbal që nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve.

KREU III
LEHTËSIMË PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE TË BASHKËPUNIMIT

Neni 11
Zyra e Kooperacionit

1. Qeveria e Republikës Italiane mund të krijojë pranë Ambasadës Italiane në Tiranë një zyrë të Kooperacionit Italian me qëllim lehtësimin e komunikimit dhe koordinimit me autoritetet shqiptare për çështjet që janë objekt i kësaj Marrëveshjeje. Ambasada Italiane në Tiranë i bën të ditur autoriteteve shqiptare ngritjen e zyrës së Kooperacionit Italian.

2. Zyra e Kooperacionit Italian përbëhet nga personel i dërguar nga Ministria e Jashtme Italiane dhe nga personel i punësuar në vend.

3. Ambasada Italiane në Tiranë i bën të ditur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë emrat e anëtarëve të Zyrës së Kooperacionit Italian, duke përcaktuar se për cilin prej tyre mund të aplikohet Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë lëshon një kartë korresponduese, në të cilën tregohet qartë titulli “Punonjës i Zyrës së Kooperacionit Italian në Republikën e Shqipërisë”.

4. Në Zyrën e Kooperacionit Italian mund të veprojnë stazhierë që kryejnë veprimtari të shkurtra praktike trajnimi. Stazhierët nuk janë pjesë e personelit të Zyrës së Kooperacionit Italian. Ata rekrutohen mbi bazën e normativave italiane. Me kërkesë të ambasadës italiane në Tiranë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, autoritetet kompetente shqiptare pajisin stazhierët me vizë dhe lejeqëndrimi për kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre.

5. Pasuritë e tundshme dhe të patundshme të Zyrës së Kooperacionit Italian janë pronë e Qeverisë së Republikës Italiane dhe gëzojnë privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet e parashikuara nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike. Përdorimi i këtyre të mirave materiale, të tundshme ose të patundshme, për qëllimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin nga privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet e parashikuara nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike.

Neni 12

Parashikime të përgjithshme lidhur me përjashtimin nga taksat fiskale dhe doganore

1. Në kuadrin e projekteve të përfshira në zbatimin e Marrëveshjes, pala shqiptare:
 - a) përjashton nga çdo detyrim doganor, taksë dhe tatim ose ndryshe të emëruar (duke përfshirë TVSH) të gjitha të mirat, përfshirë pajisjet, materialet, punët dhe shërbimet e ofruara ose financuara si dhuratë nga Republika Italiane;
 - b) jep të gjitha lejet, autorizimet, licencat, aprovimet dhe çdo dokument të nevojshëm për importimin, qoftë ky përfundimtar ose i përkohshëm, dhe rieksporimin e pajisjeve dhe të mirave të nevojshme me qëllim realizimin e projekteve.

Neni 13

Kushtet që kanë të bëjnë me institucionet e huaja, organizatat joqeveritare dhe ndërmarrjet

1. Institucione ndërkombëtare, organizata joqeveritare, ndërmarrje apo çdo person tjetër juridik me nënshtetësi jo shqiptare mund të marrin pjesë në aktivitete të bashkëpunimit të financuar nga pala italiane dhe të zhvillojnë aktivitete në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim mes palëve.

2. Vetëm për aktivitetet e vëna në jetë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes, subjektet e përmendura në pikën e mësipërme:

a) nuk konsiderohen përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të tyre në rastet kur kjo mospërmbushje ndodh për shkak të urdhrave apo instruksioneve të lidhura me sigurinë, të dhëna nga Qeverinë e Republikës Italiane;

b) gëzojnë të drejtën të importojnë dhe riekportojnë, të përjashtuar nga taksat doganore dhe çdo tatim i ngjashëm, aparaturat profesionale dhe të mirat e nevojshme me qëllim vazhdimësinë e detyrimeve të marra, apo të shesin /dhurojnë këto mjete në Republikën e Shqipërisë, kur të mos jenë më të nevojshme për arsye shërbimi pas shlyerjes së taksave doganore dhe tatimeve të ngjashme;

c) përjashtohen nga taksat dhe nga tatime të tjera të ngjashme mbi fitimet, mbi bazën e xhiros apo çdo bazë tjetër, si edhe mbi pagesat dhe shpërblimet që u paguhen atyre nga qeveria italiane për shërbimet e ofruara në kuadrin e programeve/projekteve të bashkëpunimit për zhvillim;

d) kanë të drejtë të hapin llogari bankare dhe të kryejë çdo lloj operacioni bankar për përmbushjen e detyrimeve që kanë marrë përsipër në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Mbajtja në efikasitet e këtyre llogarive nuk do të pengohet nga kontrollet mbi shkëmbimet financiare të huaja apo detyrime të vëna në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shumat në këto llogari janë lehtësisht të transferueshme në çfarëdo monedhe të konvertueshme;

e) përjashtohen gjithashtu nga çdo detyrim që ka të bëjë me regjistrimin në Republikën e Shqipërisë, për sa u përket autorizimeve profesionale, fiskale ose për çfarëdo arsye tjetër;

f) nuk janë të detyruar t'u japin asnjë informacion autoriteteve tatimore shqiptare, për aktivitete që bëjnë pjesë në kuadrin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;

g) përjashtohen nga çdo lloj detyrimi ose tatimi në rastet kur në përfundim të projektit, siç është parashikuar në Marrëveshjen e projektit, do të duhet të transferojnë pronësinë e të mirave të tundshme, të patundshme dhe të regjistruara në emër të kundërpalës lokale ose mbi përfituesin final. Të gjitha detyrimet fiskale do të mbeten në ngarkim të përfituesit final.

Neni 14

Kushte që aplikohen për personelin e huaj

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë impenjohet të marrë të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme me qëllim përjashtimin e qeverisë italiane, enteve të saj zbatuese, ekspertëve të saj dhe në përgjithësi gjithë personelit të huaj nga çdo rregullore ose akt normativ që mund të ndërhyjë në zhvillimin efikas të aktiviteteve të parashikuara në këtë Marrëveshje; gjithashtu impenjohet të garantojë çdo masë tjetër që mund të jetë e nevojshme me qëllim që të sigurojë shpejtësinë dhe efikasitetin e ndihmës italiane.

2. Kushtet vijuese do të aplikohen në Republikën e Shqipërisë ndaj personelit të huaj, jo përfundimisht rezident në vend, duke përfshirë qytetarët shqiptarë, që:

a) janë të punësuar ose në shërbimin, kryejnë në Shqipëri aktivitete të lidhura me programet/projektet e bashkëpunimit për zhvillim, të financuara këto nga pala italiane, përfshirë vullnetarët, qofshin ata laikë ose fetarë, konsulentët dhe personelin jo shqiptar të punësuar në Zyrën e Kooperacionit për Zhvillim-njësia teknike lokale e ambasadës italiane në Tiranë;

b) qofshin të martuar, bashkëjetues, të varur nga subjektet që u përgjigjen pikave të lartpërmendura.

3. Pala shqiptare impenjohet t'i garantojë këtij personeli:

a) pajisje të shpejtë, të përjashtuar nga çdo detyrim, me viza me shumë hyrje dhe dalje për gjithë periudhën e aktivitetit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

b) liri të plotë lëvizjeje brenda vendit dhe të drejtën e hyrje-daljes në masën e nevojshme për realizimin e programit/projektit ose për aktivitetet që kanë të bëjnë me Zyrën e Kooperacionit Italian;

c) pajisje të shpejtë me çdo leje apo licencë, si ndër të tjera, leje qëndrimi, leje pune, leje kërkimore dhe profesionale, përveç përjashtimit nga kushtëzimet mbi emigracionin dhe regjistrimin e të huajve për periudhën kur do të përfshihen në këtë Marrëveshje;

d) përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe nga çdo tatim tjetër që ka të bëjë me pagën që jepet nga qeveria italiane apo nga një punëdhënës, i cili duhet të furnizojë me të mira apo shërbime mbi bazën e një kontrate të nënshkruar drejtpërdrejtë, me Italinë ose me Shqipërinë, apo si nënkontraktues;

e) kushte të riatdhesimit, në rast krize kombëtare ose ndërkombëtare tërësisht të njëjta me ato të parashikuara për anëtarët e misioneve diplomatike;

f) të drejtë për të importuar ose rieksporuar të mira dhe pajisje profesionale të nevojshme për vazhdimin e misionit të tyre, duke përjashtuar nga detyrimet doganore dhe çdo detyrim tjetër fiskal.

4. Personelit që do të mbetet në shërbim për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj duhet gjithashtu t'i garantohet:

a) e drejta për të hapur dhe vepruar në një llogari bankare në Republikën e Shqipërisë për nevojat e tij personale. Kjo llogari duhet të jetë e lirë dhe të mos i nënshtrohet asnjë kontrolli mbi kurset ose tatimet shqiptare, shuma gjithashtu duhet të jetë lehtësisht e transferueshme në çdo valutë të konvertueshme;

b) përjashtimi nga çdo detyrim doganor importimi ose eksportimi, tarifë doganore apo tjetër taksë, tatime, detyrime, barrë dhe çdo tarifë tjetër e ngjashme, përfshirë dhe TVSH mbi të mirat personale dhe shtëpiake, përfshirë, por jo kufizuar në, të mirat e lidhura me banesën, të mira personale dhe automjete. Këto të mira mund t'u shiten vetëm subjekteve që gëzojnë gjithashtu të drejtën e përjashtimit tatimor. Në rast të kundërt, të mirat e importuara duhet t'u nënshtrohen pagesave të taksave dhe tatimeve përkatëse.

5. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mundet, me një akt të motivuar, të kërkojë largimin apo zëvendësimin e çdo anëtari të personelit, që është vënë në dispozicion nga Italia, shërbimi në punë apo sjellja e të cilit do të konsiderohet jo e kënaqshme. Italia mundet, në të njëjtën mënyrë, të kthejë në atdhe personelin në çdo moment.

6. Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje apo në marrëveshje të tjera të nënshkruara mes palëve, ato impenjohen të gjejnë një zgjidhje miqësore, duke pasur parasysh normativën përkatëse italiane dhe shqiptare në fjalë dhe me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të bashkëpunimit.

Neni 15

Përgjegjësitë ndaj të tretëve

1. Pala shqiptare impenjohet të garantojë imunitetin e Kooperacionit Italianit për Zhvillim dhe të enteve zbatuese në lidhje me veprimet ligjore të tentuara nga palë të treta në drejtim të tyre, apo kundër personelit në varësi të tyre, ose të subjekteve të tjera që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre në ushtrimin e funksioneve të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo dispozitë nuk aplikohet në rastet kur veprimi ligjor rrjedh nga një veprim apo mosveprim i subjekteve të lartpërmendura i kualifikuar si i qëllimshëm, ose pasojë e një faji të rëndë.

KREU IV
DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Ndryshime, interpretime dhe mosmarrëveshje

1. Çdo ndryshim i marrëveshjes në fjalë, duhet të bëhet me shkrim. Këto ndryshime hyjnë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas atij në të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për plotësimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Çdo mosmarrëveshje për sa i përket aplikimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 17

Hyrja në fuqi, tërheqja nga marrëveshja dhe kohëzgjatja

1. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas atij në të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për plotësimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Secila nga palët mund të heqë dorë me shkrim nga Marrëveshja në çdo moment. Tërheqja do të ketë efekt duke filluar nga dita e parë e muajit të tretë pas lajmërimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, vullnetit për tërheqje. Në çdo rast dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mbeten tërësisht të aplikueshme për programet dhe projektet e nisura deri në momentin e lajmërimit për tërheqje ose të mosrinovimit.

3. Marrëveshja aplikohet në të gjitha projektet në zbatim dhe në proces programimi, datën e hyrjes në fuqi, përveç ndonjë parashikimi të ndryshëm në Marrëveshjen e projektit.

Në mirëbesim, personat e poshtëshënuar, të autorizuar si duhet nga qeveritë përkatëse, nënshkruajnë këtë Marrëveshje në emër të palëve.

Nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008 në dy kopje origjinale, respektivisht në gjuhën shqipe dhe italiane, të dyja tekstet njësoj të vlefshme.

LIGJ

Nr.10 070, datë 5.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 paragrafi i parë shkronja “a” shifra “17,5” bëhet “13,8”.

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - i) në shkronjën “a” shifra “0,8” bëhet “0,3”;
 - ii) në shkronjën “b” shifra “2,3” bëhet “1,4”;
 - iii) në shkronjën “c” shifra “23,9” bëhet “21,6”.
- b) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i) në shkronjën “a” shifra “0,5” bëhet “0,3”;
 - ii) në shkronjën “b” shifra “2,0” bëhet “0,9”.

Neni 3

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 79

Detyrimet e punëdhënësit dhe të të vetëpunësuarit

Punëdhënësi dhe i vetëpunësuarit janë të detyruar:

- a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit;
- b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me ligj;
- c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuarit fillon punë;
- ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me ligj.

Rregullat e lëvizjes së informacionit dhe të dokumentacionit ndërmjet punëdhënësit, strukturave tatimore dhe strukturave të sigurimeve shoqërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Neni 81 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 81

Regjistrimi

Personat juridikë, publikë, privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, janë të detyruar të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në strukturat tatimore, sipas rregullave të përcaktuara me ligj. Regjistrimi i subjekteve, në bazë të të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe mbyllja e veprimtarisë bëhen sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Regjistrimi është akt administrativ, që nuk tregon detyrim për mbulimin me sigurime shoqërore.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2009.

**Shpallur me dekretin nr.6069, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.237, datë 5.2.2009

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Shkëlqim Bozgo emërohet anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 238, datë 5.2.2009

**PËR RIEMËRIMIN E KRYETARIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Bujar Nepravishta riemërohet Kryetar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6064, datë 19.2.2009

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------|--|
| 1. Arben Qazim Krasniqi | 11. Jonida Kujtim Xhyra-Entorf (Xhyra) |
| 2. Eva Simon Jançe (Janaqi) | 12. Gentian Halim Stafa |
| 3. Ergin Ardjan Jançe | 13. Aleksandër Gjergji Kuqi |
| 4. Ardjan Isuf Jançe | 14. Pranvera Qerim Rreci (Myftari) |
| 5. Eduard Besnik Berisha | 15. Drenica Bekim Rreci |
| 6. Halil Shyqyri Zaja | 16. Drenis Bekim Rreci |
| 7. Margarita Ahmet Zaja (Doçi) | 17. Floridian Bekim Rreci |
| 8. Ingrid Halil Zaja | 18. Ariana Vasil Pedersen (Shabani) |
| 9. Mario Halil Zaja | 19. David Elvis Përmeti |
| 10. Kreshnik Zef Çuka | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr.10, datë 30.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME PASAPORTË
LUNDRIMI**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZOJNË:

1. Pasaporta e lundrimit është dokument identifikimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijes ose personave të tjerë që mund të punojnë dhe udhëtojnë me këtë anije.
2. Personat të cilët pajisen me pasaportë lundrimi paguajnë një tarifë shërbimi prej 5 750 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë/person, për të cilën nuk aplikohet TVSH.
3. Vjelja e kësaj tarife bëhet nga Kapiteneria e Porteve të rretheve përkatëse, të cilat lëshojnë pasaportën e lundrimit.
4. Tarifat e arkëtuara, brenda 5 ditësh nga momenti i arkëtimit, derdhen në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit të rrethit përkatës.
5. Shuma e tarifave të arkëtuara sipas këtij udhëzimi, i takon 100% Buxhetit të Shtetit.
6. Modeli i pasaportës dhe procedurat e dhënies së saj përcaktohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
7. Të gjitha udhëzimet të cilat bien në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohen.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINACAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
TRANSPORTIT DHE
TEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

RREGULLORE
Nr.6, datë 13.2. 2009

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË REGJISTRIMIT TË INFORMACIONEVE TË
NEVOJSHME NË LIDHJE ME ZËNIET E PESHKUT¹**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 32 të pikës 1 të nenit 38 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën” të ndryshuar, dhe të pikës 24 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062, datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë.

Neni 1

1. Kapitenët e anijeve të peshkimit me gjatësi totale më të madhe se 10 metra regjistrojnë të dhënat në librin e anijes, sipas shtojcës I dhe pikave 17-24 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062 datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e një sistemi kontrolli për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim” për të gjitha zonat e peshkimit.

2. Libri i anijes, sipas pikës 1 të mësipërme, plotësohet edhe kur anija e peshkimit kryen aktivitet në ujëra ndërkombëtare.

3. Në librin e anijes shënohet çdo sasi e llojeve të mbajtura (të ruajtura) në bord sipas shtojcës IV.

4. Veglat e peshkimit të përdorura dhe llojet e peshkuara, sipas pikës 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062 “Për përcaktimin e kompetencave të inspektoratit të peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”, shënohen në rubrikat përkatëse të librit të anijes me kodet e përcaktuara në shtojcën III dhe kodet me tre germa të FAO ose me emrat e tyre sipas shtojcës IV.

Neni 2

1. Çdo fletë e librit të anijes përmban edhe dy kopje. Dy kopjet e fletës së librit të anijes dorëzohen pranë pikave të përcaktuara nga Drejtoria e Politikave të Peshkimit. Fleta origjinale mbetet e pashkëputur në librin e anijes si pjesë përbërëse e dokumentacionit të anijes. Një nga kopjet e fletës së librit të anijes (fleta me ngjyrë të verdhë) shërben si deklaratë zbarkimi. Kopja tjetër (fleta ngjyrë rozë) shërben për përpunim statistikor.

2. Inspektori i peshkimit i portit përkatës grumbullon fletët e depozituara; një nga kopjet e plotësuar e dërgon një herë në muaj në Drejtorinë e Politikave të Peshkimit. Kopja tjetër (deklarata e zbarkimit) mbahet nga inspektori.

3. Libri i anijes dhe deklarata e zbarkimit ose transbordimit mund të verifikohen nga inspektorati i peshkimit me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e peshkimit, përfshirë dhe këtë rregullore.

4. Inspektori i peshkimit, në rastet kur vëren se subjektet nuk kanë plotësuar librin e anijes ose dorëzuar kopjet e fletës së tij sipas pikës 1 të mësipërme, ka të drejtën t’i kërkojë Kapitenerisë së Porteve të pengojë nisjen e anijes deri në plotësimin e tyre.

¹ Kjo rregullore është në përputhje të pjesshme me rregulloren (CEE) nr.2807/83 e Komisionit European e datës 22 shtator 1983 “Që përmban rregullat e detajuara për regjistrimin e të dhënave mbi zëniat e peshkut në shtetet anëtare” (GZ L 276 e 10.10.1983, faqja 1).

Neni 3

1. Libri i anijes, deklarata e zbarkimit ose transbordimit plotësohen sipas udhëzimeve të dhëna në shtojcën II.

2. Me urdhër ministri, kërkesat që janë përcaktuar si fakultative në shtojcën II mund të bëhen të detyrueshme.

3. Toleranca në vlerësimin e sasisë së peshkut së mbajtur në bord është 20%.

4. Numri i arkave, koshave dhe enëve të tjera mbajtëse në të cilat është vendosur prodhimi, deklarohet me saktësi.

Neni 4

Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen strukturat e peshkimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

SHTOJCA II
UDHËZIM PËR KAPITENIN QË KA DETYRIMIN TË MBAJË LIBRIN E ANIJES SIPAS
MODELIT TË SHTOJCËS I

1. Parathënie

Ky udhëzim është për të gjithë kapitenët e anijeve të peshkimit që në bazë të legjislacionit shqiptar duhet të plotësojnë librin e anijes gjatë udhëtimit dhe të paraqesin një deklaratë zbarkimi/transbordimi në momentin e hyrjes në port.

2. Udhëzime në lidhje me librin e anijes

2.1 Dispozita të përgjithshme

2.1.1 Anijet që janë të detyruara të mbajnë librin e anijes

Janë të detyruar për të plotësuar librin e anijes të gjithë kapitenët e anijeve të peshkimit, të cilat kanë gjatësi totale të barabartë ose më të madhe se 10 m.

Janë gjithashtu të detyruar për të mbajtur librin e anijes kapitenët e anijeve të peshkimit me një gjatësi totale më të vogël se 10 m nëse kjo përcaktohet nga Ministria me një urdhër të dytë.

2.1.2 Mënyra për plotësimin e librit të anijes

- Libri i anijes plotësohet para mbërritjes në port.
- Libri i anijes plotësohet edhe në rast të një kontrolli në det.
- Libri i anijes plotësohet në të gjithë kërkesat e detyrueshme.
- Libri plotësohet edhe për kërkesat që mund të jenë fakultative, nëse Ministria vendos që të kthehen në të detyrueshme për anije të veçanta peshkimi. Në këtë rast Ministria përgatit udhëzime shtesë.

2.1.3 Plotësimi i librit të anijes jashtë ujërave territoriale.

- Libri i anijes plotësohet edhe kur aktiviteti i peshkimit kryhet jashtë ujërave të territoriale.

- Në rastet kur vendi, në ujërat e të cilit kryhet peshkimi, përdor një libër anijeje të ndryshëm, duhet të plotësohet vetëm libri e vendit në të cilin kryhet peshkimi.

- Në rastet kur vendi, në ujërat e të cilit kryhet peshkimi, nuk kërkon përdorimin e një libri tjetër anijeje, por kërkon të dhëna shtesë, këto të dhëna përfshihen në librin e anijes.

2.2 Të dhëna në lidhje me anijen

Në pjesën e sipërme të çdo faqeje të librit të anijes duhet të jepen informacionet e përgjithshme mbi anijen, ose aty ku është rasti mbi anijet. Sipas numrave të referencës të vendosur në çdo faqe plotësohen respektivisht këto të dhëna:

Nr. i referimit në librin e anijes (1): emri i anijes dhe nëse ka; sinjali i komunikimit në radio.

Nr. i referimit në librin e anijes (2): numri i anijes (numri i regjistrit të peshkimit, shenjat identifikuese të jashtme).

Nr. i referimit në librin e anijes (3): emri dhe mbiemri i kapitenit.

Nr. i referimit në librin e anijes (4): dita, muaji, ora dhe porti i nisjes.

Nr. i referimit në librin e anijes (5): dita, muaji, ora dhe porti i kthimit.

Nr. i referimit në librin e anijes (6): data dhe vendi i zbarkimit nëse është e ndryshme nga të dhënat e pikës (5).

Nr. i referimit në librin e anijes (7): në rast transpordimi; datën, emrin, sinjalin e komunikimit në radio nëse ka, kombësia dhe shenjat identifikuese të jashtme të anijes marrëse.

Nëse aktiviteti i peshkimit kryhet në çift, emri i anijes së dytë dhe të kapitenit të saj si dhe numri i saj i identifikimit duhet të shkruhen poshtë të dhënave të anijes e cila po plotëson librin e anijes.

Edhe kapiteni(ët) i(e) anijes(ve) tjetër duhet të mbajë një libër anijeje, duke treguar vetëm sasi të e kapura dhe të mbajtura në bord të saj, me qëllim që të dhënat të regjistrohen vetëm njëherë.

2.3 Të dhënat në lidhje me veglat (pajisjet) e peshkimit

Nr. i referimit në librin e anijes (8): vegla e peshkimit: lloji i veglës së peshkimit të përdorur duhet të tregohet sipas kodit në shtojcën III, kolona 1.

Nr. i referimit në librin e anijes (9): madhësia e syzeve të rrjetave, në milimetra.

Nr. i referimit në librin e anijes (10): madhësia e veglave të peshkimit sipas përcaktimeve në shtojcën III, kolona 2 (fakultative).

2.4 Të dhëna në lidhje me llojin e peshkimit.

2.4.1 Lloji i informacionit

Informacioni në lidhje me aktivitetin e peshkimit jepet sipas numrave të referimit të vendosura në faqet e librit të anijes, si më poshtë:

Nr. i referimit në librin e anijes (12): numri i operacioneve të peshkimit sipas përcaktimeve në shtojcën III, kolona 3 (fakultative).

Nr. i referimit në librin e anijes (13): koha e peshkimit, i kuptuar si numri i orëve në det nga të cilat hiqen orët e harxhuara për rrugën për në, ndërmjet ose nga zonat e peshkimit ose periudha në të cilën anija është në riparim, defekt ose lundrim; megjithatë numri i orëve që kalohen duke kërkuar peshkun (p.sh. me sonar) duhet të konsiderohet si kohë peshkimi; (fakultative)

Nr. i referimit në librin e anijes (14): pozicioni, zona e peshkimit.

Nr. i fletës: shënohet me numër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Politikave të Peshkimit

Libri i anijes së peshkimit

Nr. fletes	5	Viti	2009	Porti	Durres						
Emri i anijes (1)	Durresi	Nr. NFR (2)	ALB01E011800	Nr. licenses se peshkimit	999						
Peshkatore me kohe te plote	4	Me kohe te pjesshme	0	Emri i Kapitenit (3)	Emer Mbiemer						
Nisja (4)	DITA		MUAJI		ORA		nga	VITI 2009	ZONA E PESHKIMIT (14)		
	0	5	0	1	09	45				Durresi	Para Durresit
	0	7	0	1	07	30				Durres	
	0	7	0	1	09	30				Durres	
Kthimi (5)							ne				
Zbarkimi (6)							ne				

Nr	Emri i paisjes se peshkimit (8)	Syze (9)	Oret efektive te peshkimit (13)	Numri i kalatave (12)	Numri i mjeteve rrjetave	Madhesia, ose (10)	Largësia (metra)
1	Trata fundore koçe	40	30	6	1	(*)	XXXXXXXXXXXX
2	Rrjeta me rrethim			XXXXXX			
3	Mrezha			XX XX		(***)	
4	Grepa dhe linje grepash			XX X		(****)	XXXXXXXXXXXX

(*) Hapja e gojes se trates grepave

(**) Gjatesia - perimetri

(**) Nr. linjave

(****) Nr. i

Ne rast transbordimi (7)

dati

Filari i ar

NFR /CFK)

Flamuri

Nr. Paisjes (8)	Llojet e zera		Numri i ar	Pesha e arkave	Numri i peshqve te medhenj	Pesha mesatare e peshqve te medhenj	Pesha totale (15)	Vleresim i hedhurinave (16)
	Emri	kodi						
OTB	Merluc	n	20	4			80	5
	Barbun	n	12	4			48	
	Karkalec roze	dps	10	5			50	3
	Skampi	nep	2	5			10	
	Skumer	mac	4	4			16	
	Pellumb	smd			5	4	20	
	Gjel i vogel	gun	2	4			8	
	Dental	dec			1	5	5	
	Sepie	ctc	3	6			18	
	Oktapod verac	occ	3	6			18	
	Moskardin	edt	4	6			24	
	Kallamare	sqr	5	5			25	
	Hënz deti	anf	2	4			8	
TOTALI KG							330	

Deklaroj nën përgjegjësinë time se të dhënat e sipërhënuara janë të vërteta

FIRMA E KAPITENIT OSE PRONARIT _____

2.4.2 Sasitë e peshkuara dhe të mbajtura në bord (numri i referimit në librin e anijes: (15).

Duhet të tregohen në librin e anijes zëniet e të gjitha llojeve të mbajtura në bord sipas shtojcës IV.

Nëse numri total i rreshtave është i pamjaftueshëm mund të përdoret një faqe e re.

Tregohet njësia matëse e përdorur, pesha neto mesatare në kg e peshës së gjallë ose e mbajtur në njësi (kosh, arka) etj.

2.4.3 Vlerësimi i peshkut që hidhet në det/hedhurinave (numri i referimit në librin e anijes: (16)) fakultative

Tregohen sasitë e peshkut të hedhur, më e preferueshme në kg peshë e gjallë.

Këto të dhëna jepen vetëm për qëllime shkencore dhe nuk do të konsiderohen për llogaritjen e sasive.

2.5 Frekuenca e plotësimit të librit të anijes

- Përdoret një faqe e re:

- kur përdoret një mjet i ri peshkimi me syze të ndryshme nga ajo e përdorur më përpara

- për çdo operacion transbordimi ose zbarkimi të ndërmjetëm.

3. Dispozita të përgjithshme në lidhje me librin e anijes dhe deklaratën e transbordimit

3.1 Procedura për plotësimin

3.1.1 Shënimet e bëra në librin e anijes dhe në deklaratën transbordimit duhet të jenë të lexueshme dhe të pafshishme.

3.1.2 Asnjë e dhënë e shkruajtur në librin e anijes dhe në deklaratën e transbordimit nuk mund të korrigjohet ose fshihet. Në rast gabimesh, regjistrimi i pasaktë duhet të mbulohet me një vizë dhe rishkruhet duke u firmosur nga kapiteni ose përfaqësuesi i anijes.

3.1.3 Duhet të plotësohet një deklaratë transbordimi për çdo transbordim.

3.1.4 Çdo faqe e librit të anijes duhet të firmoset nga kapiteni.

3.2 Procedura e transmetimit

3.2.1 Në rastet e zbarkimit në një port të vendit në të cilin anija është e regjistruar një kopje e fletës së librit të anijes duhet të dorëzohet ose dërgohet inspektorit të peshkimit të portit përkatës jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i zbarkimit.

3.2.2 Në rastet e zbarkimit në një port të një vendi të ndryshëm nga ai në të cilin anija është e regjistruar, kopja e fletës së librit të anijes (deklarata e zbarkimit) duhet të dorëzohet ose t'i dërgohet inspektorit të peshkimit të portit pritës jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i operacioneve të zbarkimit. Kopja tjetër e fletës së librit të anijes duhet t'i dërgohet inspektorit të peshkimit të portit në të cilën anija është regjistruar jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i zbarkimit.

3.2.3 Në rastet e zbarkimit në një shtet tjetër, kopja ose kopjet e fletës së librit të anijes duhet t'i dërgohen inspektorit të peshkimit të portit në të cilën anija është regjistruar.

3.2.4 Në rastet e transbordimit në një anije tjetër, kopja e parë e deklaratës së transbordimit duhet t'i dorëzohet kapitenit të anijes që merr peshkun. Origjinali i këtij dokumenti duhet t'i dorëzohet ose dërgohet inspektoratit të peshkimit ku është regjistruar anija, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i operacioneve të zbarkimit ose të mbërritjes në port.

3.2.5 Në qoftë se kapiteni e ka të pamundur të dërgojë origjinalin ose origjinalet e librit të anijes ose të deklaratave të zbarkimit/transbordimit inspektoratit të peshkimit ku është i regjistruar anija sipas afateve kohore të përcaktuara, të dhënat e kërkuara nga shtojca 2 për deklaratën e zbarkimit duhet t'i transmetohen inspektoratit të peshkimit nëpërmjet radios ose me mjete të tjera komunikimi.

3.3. Përgjegjësia e kapitenit në lidhje me librin e anijes, deklaratën e zbarkimit dhe transbordimit.

3.3.1 Kapiteni i anijes vërteton me firmën e tij vërtetësinë e të dhënave sasiore të shkruajtura në librin e anijes ose në deklaratën e transbordimit.

3.3.2 Kapiteni i anijes vërteton me firmën e tij vërtetësinë e të dhënave të tjera të shkruara në librin e anijes dhe në deklaratën e transbordimit dhe të të gjitha elementeve në deklaratën e zbarkimit.

3.4 Kopjet e librit të anijes duhet të ruhen për një vit.

SHTOJCA III
VEGLAT E PESHKIMIT DHE AKTIVITETET E PESHKIMIT

Lloji i veglave të peshkimit	Kolona 1 Kodi	Kolona 2 Dimensionet / numrat (në metra)	Kolona 3 Njësitë e përdorimit
Tratë koçe më timonë (divergjentë)	OTB	Modeli i tratës së koçës ¹	Numri i herëve që është hedhur rrjeta (janë hedhur rrjetat)
Tratë fundore	TBB		
Dragë	DRB	Gjatësia e shufrës x numrin e shufrave Gjerësia për numër dragash	
Tratë çift fundore	PTB	Modeli i tratës ² Gjatësia totale e rrjetës	
Rrjetë daneze (e zhytur)	SDN		
Rrjetë skoceze (notuese)	SSC	Gjatësia totale e rrjetës	
Rrjetë pellagjike me timonë (divergjent)	OTM	Modeli i rrjetës fundore ¹	Numri i herëve që është hedhur rrjeta
Rrjetë pellagjike në çift	PTM	Modeli i rrjetës fundore ¹	
Rrjetë me rrethim	PS	Gjatësi, lartësi	Numri i herëve që është hedhur rrjeta
Njicat	GN	Gjatësi, lartësi	Numri i rrjetave të hedhura në ujë gjatë ditës së referuar Numri i rrjetave të hedhura në ujë gjatë ditës së referuar Numri i rrjetave të hedhura në ujë gjatë ditës së referuar Numri i rrjetave të hedhura në ujë gjatë ditës së referuar
Njicat fikse	GNS	Gjatësi, lartësi	
Njicat notuese	GND	Gjatësi, lartësi	
Mrezhat	GTR	Gjatësi, lartësi	
Linja grepash (longlines)	LL	Numër grepash të hedhura për çdo ditë dhe për çdo linjë	
Linja grepash (të fiksuara)	LLS		
Linja grepash (notuese)	LLD		
Grepa dore dhe grepa me kallam	LHP	Numri i përgjithshëm i grepave / linjave të hedhura në ujë për çdo ditë ³	
Kurthe	FPO	Numër kurthesh të hedhura në ujë gjatë ditës së referuar	
Vegël peshkimi e paspecifikuar	MIS		

¹ Specifikon modelin e tratës siç është emërtuar nga prodhuesi i rrjetës. Si mënyrë alternative, perimetrimin e hapjes = numri i syzeve x madhësinë e syzeve mund të tregohet nëse kjo vlerë është e njohur.

² Të jepet numri i grepave dhe i linjave i ndarë nga një vizë ndarëse

SHTOJCA IV
LISTA E LLOJEVE TË MBAJTURA NË BORD QË DUHET TË RREGJISTROHEN NË
LIBRIN E ANIJES DHE DEKLARATËN E ZËNIES NGA ANIJET E PESHKIMIT

Nr	Emri	Emri latinisht	Kodi FAO me tre shkronja
Molusqet bivalvorë			
1.	Biçaku	Solen spp.	RAZ
2.	Fasolari	Callista chione	KLK
3.	Freskorja (kapesanta)	Pecten jacobeus	SJA
4.	Midhja e zakonshme	Mytilus galloprovincialis	MSM
5.	Ostrea (ostrika)	Ostrea spp.	OYX
6.	Tartufi i detit	Venus verrucosa	VEV
7.	Telini	Donax trunculus	DXL
8.	Vongola	Chamelea gallina	SVE
9.	Vongola filipine	Ruditapes philippinarum	CLJ
10.	Vongola veraçe	Ruditapes decussatus	CTG
Molusqet cefalopodë			
1.	Kallamari i butë	Loligo spp.	SQC
2.	Kallamari i egër (totani)	Illex coindetii	SQM
3.	Oktapod moskardin	Eledone spp.	OCM
4.	Oktapodi i zakonshëm (veraç)	Octopus spp.	OCZ
5.	Sepia e zakonshme	Sepia officinalis	CTC
6.	Sepiolina	Sepietta oweniana	ITW
Krustacetë			
1.	Aragosta	Palinurus elephas	SLO
2.	Astiçe	Homarus gammarus	LBE
3.	Çikala	Squilla mantis	MTS
4.	Çikala greke (e madhe)	Scyllarides latus	YLL
5.	Karkaleci i butë	Penaeus kerathurus	TGS
6.	Karkaleci i kuq	Aristaeomorpha foliacea	ARS
7.	Karkaleci rozë	Parapenaeus longirostris	DPS
8.	Skampi	Nephrops norvegicus	NEP
Peshqit			
1.	Açuga	Engraulis encrasicolus	ANE
2.	Ame	Argyrosomus regius	MGR
3.	Barbuni	Mullus barbatus	MUT
4.	Barbuni i shkëmbit	Mullus surmuletus	MUR
5.	Bishtëllenjësja (romb)	Scophthalmus rhombus	BLL
6.	Bli turigjatë (me pika)	Acipenser stellatus	APE
7.	Blini i bardhë	Acipenser naccarii	AAA
8.	Blini turigjatë	Acipenser sturio	APU
9.	Bukla	Stromateus fiatola	BLB
10.	Dentali	Dentex spp.	DEX
11.	Dreq deti	Trachinus spp.	WEX
12.	Gjeli i kuq (i vogël)	Chelidonichthys spp.	GUI
13.	Gjuhëz (Gjuza)	Solea spp.	SOO
14.	Gofa	Seriola dumerili	AMB
15.	Gofë	Pomatomus saltatrix	BLU

16.	Hënëz deti (peskatriçe)	<i>Lophius piscatorius</i>	MON
17.	Hënëz deti e verdhë	<i>Lophius budegassa</i>	ANK
18.	Kavall deti	<i>Petromyzon marinus</i>	LAU
19.	Kern (kerri)	<i>Epinephelus</i> spp.	GPX
20.	Kerr	<i>Serranus</i> spp.	BAS
21.	Kerr fundi	<i>Polyprion americanus</i>	WRF
22.	Koce	<i>Sparus auratus</i>	SBG
23.	Korb i bardhë	<i>Umbrina cirrosa</i>	COB
24.	Korb i zi	<i>Sciaena umbra</i>	CBM
25.	Korifenë	<i>Coryphaena hippurus</i>	DOL
26.	Kubla	<i>Alosa fallax</i>	TSD
27.	Levreku	<i>Dicentrarchus labrax</i>	BSS
28.	Lojba	<i>Lichia amia</i>	LEE
29.	Lojbë pikaloshe	<i>Trachinotus ovatus</i>	POP
30.	Lopë deti	<i>Mobula mobular</i>	RMM
31.	Mace-deti (Dac deti)	<i>Scyliorhinus</i> spp.	SCL
32.	Maridhe	<i>Spicara</i> spp.	PIC
33.	Melanur	<i>Oblada melanura</i>	SBS
34.	Menulla	<i>Labrus merula</i>	WRM
35.	Mërinë	<i>Muraena helena</i>	MMH
36.	Merluc tripendësh	<i>Micromesistius poutassou</i>	WHB
37.	Merluci	<i>Merluccius merluccius</i>	HKE
38.	Motele	<i>Gaidropsarus</i> spp.	ROL
39.	Murra	<i>Lithognathus mormyrus</i>	SSB
40.	Murroku	<i>Centrolophus niger</i>	CEO
41.	Neshtelie (shkotërr)	<i>Dasyatis</i> spp.	STI
42.	Ngjala	<i>Anguilla anguilla</i>	ELE
43.	Ngjalë e egër	<i>Conger conger</i>	COE
44.	Pagri	<i>Pagrus pagrus</i>	RPG
45.	Pallamiti	<i>Sarda sarda</i>	BON
46.	Papaline	<i>Sprattus sprattus</i>	SPR
47.	Peshk çekiç	<i>Sphyrna zygaena</i>	SPZ
48.	Peshk çibuk	<i>Uranoscopus scaber</i>	UUC
49.	Peshk elektrik	<i>Torpedo</i> spp.	TOE
50.	Peshk gështenjë	<i>Chromis chromis</i>	CMK
51.	Peshk gjel	<i>Trigla</i> spp.	GUY
52.	Peshk jatagan (shpatë)	<i>Lepidopus caudatus</i>	SFS
53.	Peshk kitarë	<i>Rhinobatos</i> spp.	GUZ
54.	Peshk kovaç	<i>Zeus faber</i>	JOD
55.	Peshk lakuriq	<i>Trisopterus minutus</i>	POD
56.	Peshk lepur	<i>Ranzania laevis</i>	RZV
57.	Peshk pëllumb	<i>Mustelus</i> spp.	SDV
58.	Peshk pilot	<i>Naucrates ductor</i>	NAU
59.	Peshk velundrues	<i>Zu cristatus</i>	ZUC
60.	Peshk venduzë	<i>Remora</i> spp.	REM
61.	Peshkaqen jeshil (blu)	<i>Prionace glauca</i>	BSH
62.	Peshkaqen shtegtar	<i>Cetorhinus maximus</i>	BSK
63.	Peshkdhelpër	<i>Alopias vulpinus</i>	ALV

64.	Peshk-fik i fundit	Phycis spp.	FOX
65.	Peshku lejlek	Belone belone belone	GAR
66.	Peshku shtizë	Xiphias gladius	SWO
67.	Qefull buzëmadh	Oedalechilus labeo	ODL
68.	Qefull veshar	Liza aurata	MGA
69.	Qefull veshverdhë	Liza saliens	LZS
70.	Qefulli i dimrit	Chelon labrosus	MLR
71.	Qefulli i verës	Mugil cephalus	MUF
72.	Qefulli i vjeshtës	Liza ramada	MGC
73.	Rajat (raxhat, ferrëzat)	Rajidae	RAJ
74.	Salpe	Sarpa salpa	SLM
75.	Sardele	Sardina pilchardus	PIL
76.	Sardinele	Sardinella aurita	SAA
77.	Sargu	Diplodus sargus sargus	SWA
78.	Sargu bishtzi	Diplodus annularis	ANN
79.	Sargu i zi	Diplodus cervinus	SBZ
80.	Sargua	Diplodus vulgaris	CTB
81.	Sharan	Diplodus puntazzo	SHR
82.	Shkërp i thellesise	Helicolenus dactylopterus	BRF
83.	Shkërpi	Scorpaena spp.	SCS
84.	Shkotër	Psetta maxima	TUR
85.	Shqiponje deti	Myliobatis aquila	MYL
86.	Shtizë (trapadar, barrakudë)	Sphyaena sphyraena	YRS
87.	Skadhinë	Squatina oculata	SUT
88.	Skadhinë e butë	Squatina squatina	AGN
89.	Skumbri (kolo)	Scomber spp.	MAZ
90.	Skumri i madh	Auxis rochei	FRZ
91.	Spalcat e kuqe (eritrinat)	Pagellus spp.	PAX
92.	Sqepaluk	Scomberesox saurus	SAU
93.	Sqepok	Lepadogaster lepadogaster	GLP
94.	Stavridhi	Trachurus spp.	JAX
95.	Ton pendgjatë	Thunnus alalunga	ALB
96.	Toni	Thunnus thynnus thynnus	BFT
97.	Tonil	Lamna nasus	POR
98.	Troftë deti	Argentina sphyraena	ARY
99.	Trup	Euthynnus alletteratus	LTA
100.	Ushojzë e zezë	Platichthys flesus luscus	FLE
101.	Vopa	Boops boops	BOG

UDHËZIM
Nr.1, datë 20.2.2009

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSONIMIN E ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, pika 22, nenit 23, pika 1, germa "b" të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim mënyrën e organizimit dhe të funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e zyrave rajonale zgjedhore, si dhe caktimin e rregullave mbi marrëdhëniet me KQZ-në dhe komunikimi me të tretët.

Neni 2

Parime të përgjithshme

a) Zyrat rajonale zgjedhore ngrihen me qëllim zbatimin e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

b) Zyrat rajonale zgjedhore shërbejnë për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të qeverisjes vendore, në funksion të miradministrimit të procesit zgjedhor dhe rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së.

c) Në asnjë rast ZRZ-të nuk paraqiten si organe vendimmarrëse. Ato kanë një funksion tërësisht mbështetës në punën e administratës së KQZ-së.

Neni 3

Gjatë veprimtarisë së tyre ZRZ-të udhëhiqen nga parimet bazë të administrimit të një procesi zgjedhor, si:

- a) ligjshmëria,
- b) transparenca,
- c) paanshmëria,
- d) profesionalizmi.

PJESA II

VENDNDODHJA DHE PERSONELI I ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 4

Vendndodhja

Zyrat rajonale zgjedhore do të ngrihen në qendrat e 12 qarqeve të vendit: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Neni 5
Përbërja e personelit

Secila zyrë për këto zgjedhje do të përbëhet nga inspektori rajonal dhe ndihmësinpektori.

Neni 6
Inspektori rajonal dhe ndihmësinpektori

Në përzgjedhjen e stafit të zyrës rajonale zgjedhore mbahen parasysh kriteret e veçanta, të renditura si vijon:

- a) Të kenë arsimin e lartë, me përparësi atë juridik.
- b) Të kenë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratë dhe/ose në fushën e zgjedhjeve.
- c) Të njohin programet bazë të kompjuterit.
- d) Të mos kenë qenë anëtar i ndonjë partie politike në tre vitet e fundit.
- e) Të mos jenë kandidat në listën shumëmemërore të partive politike apo i zgjedhur në organet e qeverisjes vendore.
- f) Të mos jenë ushtarak, punonjës i Policisë së Shtetit dhe Shërbimin Informativ Shtetëror.
- g) Të jenë me vendbanim në qytetin qendër qarku.

Neni 7
Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës inspektori rajonal dhe ndihmësinpektori janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit sipas modelit që përdoret nga administrata e KQZ-së.

PJESA III
**EMËRIMI DHE SHKARKIMI I INSPEKTORIT DHE NDIHMËSINSPEKTORIT TË
ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE**

Neni 8
Emërimi i inspektorit të zyrës rajonale zgjedhore

Përzgjedhja e inspektorit dhe ndihmësinpektorit të zyrës rajonale kalon në këto procedura:

- a) Shpallja në median e shkruar për pozicionin e punës të inspektorit dhe ndihmësinpektorit rajonal së bashku me kriteret e duhura për pranimin e tyre.
- b) Përzgjedhja e kandidatave të paraqitura për këto vende pune do të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, Drejtori i Komisioneve Zgjedhore dhe Drejtori i Logjistikës.
- c) Titullari i institucionit nxjerr urdhrin për lidhjen e kontratave individuale të punës.

Neni 9

Shkarkimi i inspektorit dhe ndihmësinspektorit të zyrës Rajonale zgjedhore

Inspektori dhe ndihmësinspektori i zyrës rajonale zgjedhore shkarkohet nga detyra kur:

- a) nuk zbaton detyrat e ngarkuara;
- b) shkel parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi;
- c) kur nuk plotëson kërkesat e nenit 6 të këtij udhëzimi

PJESA IV

DETYRAT DHE TË DREJTAT E INSPEKTORIT TË ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 10

Detyrat e inspektorit të zyrës rajonale zgjedhore

Inspektori dhe ndihmësinspektori i Zyrës Rajonale Zgjedhore kanë për epror të drejtpërdrejtë Drejtorin e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore dhe kryen detyra të karakterit ekzekutiv dhe organizativ si më poshtë:

- a) Ndihmojnë në përcjelljen në kohë të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së në KZAZ-të përkatëse, si dhe përcjelljen e vendimeve të KZAZ-ve në KQZ.
- b) Japin ndihmesë në organizimin e trajnimeve të komisionerëve zgjedhorë, të niveleve të dyta dhe të treta, lidhur me sigurimin e infrastrukturës trajnuese etj.
- c) Mbajnë kontakte të vazhdueshme me organet e qeverisjes vendore për sigurimin në kushte optimale të ambienteve të punës që do të përdoren nga KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të.
- d) Ndihmojnë procesin e shpërndarjes së bazës materiale në destinacionin e duhur brenda afateve të përcaktuara në ligj.
- e) Informojnë KQZ-në në mënyrë të vazhdueshme mbi aktivitetin e komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta;
- f) Kryejnë detyra të tjera sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

Neni 11

Të drejtat e inspektorit dhe ndihmësinspektorit të zyrës rajonale zgjedhore

Inspektori dhe ndihmësinspektori i ZRZ-së kanë mbështetjen e KQZ-së në kryerjen e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim. Atyre u garantohen kushte të përshtatshme për zhvillimin normal të aktivitetit të tyre.

Neni 12

Komunikimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- a) Çdo lloj raporti apo informacioni, i çdo natyre që të jetë, i ZRZ-së, pasi protokollohet nga drejtoria përkatëse, u shpërndahet menjëherë anëtarëve të KQZ-së.
- b) Këto zyra kanë detyrimin t'u përgjigjen kërkesave për informacion të çdo anëtari të KQZ-së dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me ta.

PJESA V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13
Periudha e funksionimit

Zyrat rajonale zgjedhore janë të përkohshme dhe funksionojnë për një periudhë pesë mujore, në çdo rast jo më vonë se një muaj pas ditës së zgjedhjeve.

Neni 14
Koha e punës

Stafi i zyrës rajonale zgjedhore zhvillon aktivitetin e vet sipas orarit të punës që aplikohet nga administrata e KQZ-së.

Neni 15
Paga

Niveli i pagës së inspektorit dhe ndihmësinsektorit rajonal përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 16
Baza materiale dhe dokumentacioni

E gjithë baza materiale e marrë në dorëzim nga ZRZ-ja (kompjuter, printer, aparat fotokopje, telefon & faksi etj.) dhe çdo dokumentacion tjetër i përdorur nga kjo zyrë, në përfundim të periudhës së funksionimit të saj dorëzohet në KQZ, sipas procesverbalit të marrë në dorëzim.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Arben Ristani

VENDIM
Nr.8, datë 4.2.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENPOWER ALBANIA” SHPK, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa “g”, 13, dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuara me vendimin e bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.2.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

1. Me vendimin nr.127, datë 14.11.2008, Bordi i Komisionerëve vendosi fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë sipas “Rregullores për procedurat e licencimit modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të tregut ta njoftojë “Enpower Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.755, datë 30.1.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV K8”
SUBJEKTIT: “TV 11” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “TV 11” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, me afat deri më 31.12.2012 nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qarkun e Vlorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.756, datë 30.1.2009

PËR MOSZGJERIM ZONE LICENCIMI
PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV FOKUS”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos zgjerohë zonën e licencimit të televizionit privat vendor “TV Fokus”, pasi në përfundim të vlerësimit me pikë, ky subjekt u rendit në vend të dytë.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM

Nr.757, datë 30.1.2009

**PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO, VENDORE PRIVATE “RADIO KISS”
SUBJEKTIT: “TOK MEDIA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “Tok Media” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej (3) tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programe, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Mesila Doda (Demi)**

VENDIM

Nr.758, datë 30.1.2009

**PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO ORA”
SUBJEKTIT: “ORA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “ORA” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej (3) tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programe, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Mesila Doda (Demi)**

VENDIM
Nr.759, datë 30.1.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION VENDORE PRIVATE “SPARTAK SM”
SUBJEKTIT: Z.SPARTAK MERAKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit privat fizik z.Spartak Meraku licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej (3) tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Bilishtit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programe, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.760, datë 30.1.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO JEHONA”
SUBJEKTIT: “RADIO JEHONA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “Radio Jehona” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej (3) tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Shkodrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programe, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
NR.761, DATË 30.1.2009

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO TAKE 5”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “Take 5” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungojnë të dhënat e kapitalit financiar.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.762, datë 30.1.2009

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO G-KAM”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “G-KAM” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungojnë të dhënat e kapitalit financiar dhe garancia bankare.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.763, datë 30.1.2009

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO DAJÇI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikë e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.750, datë 7.11.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin privat fizik z.Mati Ftoni, pasi në dokumentacionin e paraqitur, vlera e pajisjeve të transmetimit (rreth 0.7 milionë lekë) nuk përmbushin kriterin e vendosur nga KKRT për kapitalin.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.768, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ROCK”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privat rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Rock”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.769, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KOMBI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV KOMBI”, për një afat të ri 6-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive me kabëll.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 17.11.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.770, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV
KOPLIKU”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privat rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “TV Kopliku”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.9.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.771, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO DJ 96.1”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio DJ.96.1”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 17.11.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.772, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV
TELE 1”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizioni publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privat rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat kabllor “TV Tele 1”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.773, datë 30.1.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“2ATV”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizioni publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privat rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “2A TV”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.9.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË
Nr.246/2, datë 30.1.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Rrëshen”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga grupi i punës ngritur në këtë qëllim, vlerësim i cili është miratuar më pas nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listë emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 857 712 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë.

LISTA E OBJEKTEVE NË PRONËSI PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT “MILOT-RRËSHEN”

Nr.	Lloji i objektit	Emri i pronarit	Segmenti	Vlera lekë
1	Shtëpi banimi	Fran Mark Karagjozi	Milot-Rrëshen	3499765
2	Mur guri	Lek Bitraj	Milot-Rrëshen	43063
3	Mur rrethues	Zef Llesh Fusha	Milot-Rrëshen	514319
4	Klaçeto	Arben Bitri	Milot-Rrëshen	800565
		Totali		4857712

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 25.2.2009
Doli nga shtypi më 27.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë